

# Transformim Digjital Gjithëpërfshirës i Tërë Shoqërisë Vlerësimi i Gatishmërisë Digjitale (VGD)




## Përmbledhje e projektit

Teknologjitë digjitale në zhvillim dhe ato të ardhshmet si dhe mundësitë që ato ofrojnë, veçanërisht marrë parasysh pandeminë COVID-19, kanë potencialin për ta përmirësuar thellësisht mënyrën në të cilën ofruet e shërbimeve publike dhe institucionet angazhohen, ofrojnë shërbime dhe u mundësojnë qytetarëve të kenë jetë të shëndetshme dhe produktive, por gjithashtu mund të krijojnë lloje të reja të cenueshmërive, pabarazive dhe përjashtimit. Duke e njohur këtë potencial, *Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)* ka nisur një transformim digjital në mbarë organizatën që do ta ngulisë digjitalin në ADN-në e vet - duke e shfrytëzuar këtë potencial për të bërë mirë për më shumë njerëz, dhe më shpejt.

Teksa institucionet e Kosovës janë duke u përgatitur për zhvillimin e Strategjisë për *Agjendën Digjitale për të Ardhmen e Kosovës*, UNDP-ja po piloton një mjet të ri global për *Vlerësimin e Gatishmërisë Digjitale* në Kosovë, në mënyrë që të hartëzohet forma, ritmi dhe llojet e tranzicioneve që po ndodhin dhe çfarë mund të bëhet për ta përshpejtuar tranzicionin, duke u siguruar që askush të mos mbetet pas, në kuadër të masterplanit digjital për të gjithë shoqërinë dhe gjeneratës së ardhshme.

## Çka duam të arrijmë?

- Të shfrytëzojmë kornizën ekzistuese për **transformimin digjital gjithëpërfshirës dhe të tërë shoqërisë** që do të përdoret si një model i përgjithshëm referimi për të identifikuar, strukturuar dhe priorizuar përpjekjet dhe agjendat për transformim digjital në Kosovë, duke siguruar që **askush të mos mbetet prapa** në tranzicionin drejt një shoqërie dhe ekonomie digjitale;
- Përmes një Vlerësimi të Gatishmërisë Digjitale (VGD) dhe procesit pasues konsultativ, të vendoset një bazë për angazhimin në Kosovë me partnerët, dhe përmes bashkëpunimit ekzistues dhe të ardhshëm mund të përshpejtohet transformimi digjital në Kosovë;
- Të mbështetet një qasje e koordinuar për transformimin digjital ndërmjet institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile dhe sektorit privat.



## Pamje e shpejtë e procesit:

- **Të dhënat e zërthyerat** në nivele të ndryshme të imtësisë dhe të grupeve të përdoruesve janë thelbësore për të kuptuar pikat e rregullimit të përshpejtuesit dhe pengesat;
- **VGD** kombinon rezultatet nga mjeti i **anketës me të dhëna të jashtme** për të siguruar një pasqyrë holistike të gjendjes dhe gatishmërisë digjitale në Kosovë. Anketa online mund të plotësohet shpejt kudo nga ministratë ndër-sektoriale dhe zyrtarët e institucioneve (nivele të ndryshme); OSHC lokale dhe komuniteti i biznesit dhe teknologjisë me njohuri për gjendjen digjitale në Kosovë.
- **Analiza e mëtejshme** do të bëhet bazuar në punën e mbështetur, mjetet e përdorura dhe vlerësimet e bëra nga partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët e Kosovës.
- **Anketa e Vizualizuar dhe Analiza e të Dhënave** do të përdoren për të nxitur diskutime të nivelit të lartë bazuar në njohuritë e UNDP-së.
- Pas përfundimit të kësaj VGD-je, hulumtimi do të shtrihet në dy faza të tjera: 1) **Zgjerimi në Shkallë më të Lartë** (për t'u fokusuar tek Komunitat dhe Qytetarët) dhe 2) **Zgjerimi i Sektorit** (për t'u fokusuar tek Mundësitë Sektoriale).
- Procesi i plotë është shtesë e të gjitha sistemeve dhe mjeteve ekzistuese, dhe nuk do të shërbejë për t'i zëvendësuar, por përkundrazi për t'i **plotësuar dhe për të ndërtuar sinergji**.

## Statusi:

Aktiv

## Korniza kohore:

Dhjetor 2020 – në vazhdim

## Ku:

Kosovë

## Fusha e fokusit:

Portfolio ndër-sektorial për transformimin digjital

## Përfituesit:

Institucionet e Kosovës, shoqëria civile, dhe sektori privat.

## Partnerët:

Institucionet e Kosovës, komunitetet teknologjike dhe afariste.

## Donator(ë):

UNDP

## Buxheti:

Buxheti themelor

## Kontakt:

### Niels Vestergaard Knudsen

Zëvendës Përfaqësues i Përhershëm  
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Rr. e Zagrebit 58, 10000 Prishtinë  
Kosovë

+383 49 788 918 (mobile)

[niels.knudsen@undp.org](mailto:niels.knudsen@undp.org)